REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:	2019:271380
Datë:	19.01.2024
Numri i dokumentit:	05215579

ARJ.nr.209/2023

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Rrustem Thaqi, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Sh. G., nga H., rr. "B.." , kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,(KPMSHCK), dhe palës me interes Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me bazë juridike anulim i vendimit administrativ të organit të paditur, duke vendosur sipas kërkesës së paditësit, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.192/2022 të datës 26.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18 Janar 2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditësit Sh.G., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.192/2022 të datës 26.10.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.192/2022 të datës 26.10.2023, është vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit Sh.G., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1401/2018, i datës 30.12.2021, **VËRTETOHET.**

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit paditësi Sh. G., në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Propozon që të aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa të anulohet Aktgjykimi

2023:251326

i Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.192/2022 i datës 26.10.2023 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.1401/2018, i datës 30.12.2021, dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Vendimin e të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë (KPMSHCK) A.nr.147/2018, të datës 17.05.2018, është hedhur poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.147/2018 e datës 19.03.2018, e parashtruar nga ankuesi Sh. G. me arsyetimin se, e njëjta është parashtruar para afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 12 paragraf 3, nën paragraf 3.1 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se duhet të bëhet shterrja e procedurave të brendshme të ankesave të organit të punësimit.

Kundër vendimit të lartë cekur të KPMSHCK paditësi me padi fillon konflikt administrativ. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.1401/2018, të datës 30.12.2021, në dispozitiv ka vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, Sh.G., me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet, vendimi i të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me A.nr.147/2018 i datës 17.05.2018.

Gjykata e shkallës së parë arsyeton ndër të tjera se: Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, iu referua Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, nenit 125 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")".* Ndërsa me nenin 98 të këtij ligji është paraparë afati për përfundimin e procedurës administrative, ku në paragrafin 1 dhe 2 është theksuar: *"1 Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.*

Tutje gjykata e shkallës së parë i referohet edhe dispozitave të Rregullores nr.05/2011, për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, nenit 8.2 , ku përcaktohet se, *"Ankesa duhet të bëhet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës".* Po ashtu nenit 12 paragrafi 3 Ligjit për KPMSHCK, sipas të cilit përcaktohet se , *3.1. që para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave të organit përkatës të punësimit, përveç nëse Këshilli e përjashton këtë*

2023:251326

kërkesë për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjidhur ankesën brenda tridhjetë (30) ditësh ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm". Prandaj, thekson se bazuar në dispozitat ligjore të theksuara më lartë, rezulton se nëpunësi i shërbimit civil, në rast se pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, duhet të parashtrojë mjetet e lejuara juridike në organin e punësimit dhe të pres përfundimin e procedurës administrative pranë organeve administrative si në afatet e përcaktuar ligjore si më lartë e pastaj ti drejtohet si në këtë rast KPMSHCK.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë: Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, lidhur me çështjen objekt i padisë, dhe ankesa e paditësit drejtuar të padituës bëhet e qartë se paditësi nuk kishte vepruar në shtjerrien e mjeteve juridike para se ti drejtohej KMPSHC. Pasi që i njëjti nëpërmes ankesës vet kishte deklaruar: *"unë ju drejtova me një kërkesë kryesuesit të KGJK, drejtorit të SKGJK dhe drejtorit ligjor të SKGJK, por nuk mora asnjë përgjigje dhe prapë ju drejtova edhe Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në SKGJK, po ky komision as që e ka pranuar ankesën nga zyra e arhivës së SKGJK me një arsyetim gojor se ky rast është punë e Gjykatës Supreme…",* e nga ky deklarim shihet se paditësi nuk kishte kërkuar përfundimin e procedurës administrative para organit të shkallës së parë para se ti drejtohej KPMSHCK.

Lidhur me pretendimet e paditësit se, i njëjti me kohë ka parashtruar kërkesë dhe ankesë para organit të shkallës së parë, kishte dorëzuar në gjykatë si provë Kërkesën për ndryshim të koeficientit të datës 19.01.2018 dhe ankesën për ndryshimin e koeficientit drejtuar KZKA me datë 09.03.2018, gjykata e shkallës së parë konstatoi se të njëjtat, kërkesa dhe ankesa u vërtetua se nuk përmbajnë kurrfarë vule apo datë të pranimit. Megjithatë, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se edhe nëse të njëjtat do të vërtetohej se janë pranuar nga e pala e interesit-si organ i shkallës së parë, marr parasysh datën e përpilimit në këtë rast të ankesës 09.03.2018, lehtë dëshmohet se paditësi nuk ka pritur të kalonin afatet ligjore për trajtimin e ankesës, por me datë 19.03.2018 para afatit i është drejtuar të padituës KPMSHCK. Pretendimet e paditësit gjykata e shkallës së parë i refuzoi në tërësi si të pabazuara dhe në kuptim të nenit 5, 6, 38 dhe 46.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj gjykata e shkallës së dytë, ndër të tjera vlerëson se: gjykata e shkallës së parë për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, me të drejtë i'u ka referua dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031, të LPPA përkatësisht nenit 125 par.1, nenit 98 si dhe nenit 74 paragrafi 5 dhe 6, Rregullores nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, nenit 8.2 të të njëjtës, Ligjit për KPMSHCK, nenit 12 paragrafi 3.

2023:251326

Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Andaj thëniet e ankesës ky kolegj nuk i aprovoi sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe në kuptim të nenit 49 të LKA-së dhe 200, të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vepruar me refuzimin si të pabazuar të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimin e shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pabazuar të kërkesë padisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, ka rezultuar se vendimi i të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë (KPMSHCK), A.nr.147/2018, të datës 17.05.2018, me të cilin është hedhur poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.147/2018 e datës 19.03.2018, parashtruar nga ankuesi Sh. G., me arsyetimin se e njëjta është parashtruar para afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 12 paragraf 3, nën paragraf 3.1 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se duhet të bëhet shterja e procedurave të brendshme të ankesave të organit të punësimit është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Me vendimin me nr.prot.01/640 të datës 28.10.2015, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në përputhje me Rregulloren e KGJK-së nr.12/2015 për Veprimtarinë, Organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ankuesi tani paditësi Sh.G. është sistemuar në Gjykatën Supreme të Kosovës si Zyrtar i Prokurimit. Në pikën 3 të dispozitivit të këtij vendimi është theksuar se ky vendim për pikën 1, nga nënpikat (i) deri në (xiii) dhe pikën 2, zbatohet prej datës 1 nëntor 2015 ndërsa obligohet njësiti për Administratë të Përgjithshme të SKGJK-së që të ndërmerr veprimet për ndryshime në akt-emërime. Në këshillën juridike theksohet se zyrtarët e cekur në dispozitiv të vendimit, të cilët janë të pakënaqur me këtë vendim mund ti drejtohen Këshillit Gjyqësor të Kosovës në afat prej 8 (tetë) ditësh. Ndërsa me vendimin nr.03/2153 të datës 29.12.2015, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), në pikën 2, paga dhe koeficienti i tij ngelet 7.5, deri në aprovimin e gradave.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i lartë cekur i të paditurit KPMSHCK është ligjërisht i drejtë në kuptim të dispozitave nga neni 12 paragraf 3, nën paragraf 3.1 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), sepse nga thëniet e ankuesit në ankesën e parashtruar tek e paditura KPMSHCK, të datës 19.03.2018, ku thekson se; "*unë ju drejtova me një kërkesë kryesuesit të KGJK, drejtorit të SKGJK dhe drejtorit*

2023:251326

ligjor të SKGJK, por nuk mora asnjë përgjigje dhe prapë ju drejtova edhe Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në SKGJK, po ky komision as që e ka pranuar ankesën nga zyra e arhivës së SKGJK me një arsyetim gojor se ky rast është punë e Gjykatës Supreme…". Nga kjo provohet se ankuesi tani paditësi është dashur që për mos pranimin e ankesës së tij nga ana e Zyrës së arkivës së SKGJK-së, të veproj sipas dispozitave ligjore të nenit 74 paragraf 5 dhe 6 të Ligjit nr.05/L-031për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Sipas nenit 12, paragraf 3, nën paragraf 3.1, të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), përcaktohet se: "*që para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave të organit përkatës të punësimit, përveç nëse Këshilli e përjashton këtë kërkesë për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjidhur ankesën brenda tridhjetë (30) ditësh ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm".*

Sipas nenit 74 paragraf 5 dhe 6 të Ligjit nr.05/L-031për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se: "*5.Një kërkesë me shkrim, gjithashtu mund të parashtrohet me postë apo në mënyrë elektronike drejtpërdrejtë në adresën zyrtare të organit të cilit i drejtohet, si dhe 6. Një kërkesë me shkrim, gjithashtu mund të parashtrohet edhe ën kutinë postare të organit të cilit i drejtohet".*

Nga shkresat e lëndës dhe nga vërtetimi i gjendjes faktike në gjykatën e shkallës së parë, konstatohet se paditësi gjykatës nuk i ka ofruar dëshmi se ankesa e datës 09.03.2018, dhe kërkesa e datës 19.01.2018 për ndryshimin e koeficientit, parashtruar nga i njëjti, përmbajnë vulë të protokollit apo datë të pranimit, të organit të brendshëm të punësimit, gjë që do të bënte të besueshme shtjerrjen e mjetit juridik brenda organit të punësimit. Megjithëse, edhe sikur kërkesa dhe ankesa të supozohej se i është dorëzuar organit të brendshëm të punësimit, me anë të ankesës të datës 19.03.2018 parashtruar tek e paditura KPMSHCK, lehtë vërtetohet se paditësi nuk ka pritur të kalojnë afatet ligjore për trajtimin e tyre në organin i punësimit por para afatit ligjor i është drejtuar të paditurës KPMSHCK.

Sipas nenit 98 paragraf 1 dhe 2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se:*"1 Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.* Ndërsa sipas nenit 125 paragrafi 1, është përcaktuar: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative").*

Pretendimet e paditësit të theksuara në kërkesë, se gjykata bie ndesh me parimin e informimit dhe ndihmës aktive, sipas nenit 11 të LPPA, kolegji i kësaj gjykate e konsideron të pabazuar dhe të paqëndrueshëm, sepse as nga shkresat e lëndës dhe as nga provat e dorëzuara nga paditësi në këtë gjykatë nuk provohen pretendimet e të njëjtit. Për më tepër, përmes këshillës juridike të

2023:251326

dhënë në vendimin nr.prot.01/640 të datës 28.10.2015, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, paditësi është njoftuar për të drejtën e tij për parashtrimin e ankesës në KGJK në afat prej 8 (tetë) ditësh. Po ashtu parimi se në vetvete ngërthen detyrimin e organit të administratës që pala të informohet deri në atë masë sa nuk cenohet e drejta dhe interesi i palës tjetër, sepse në të kundërtën nuk do të respektohej parimi i barazisë së palëve në procedurë administrative.Detyrimi i organit publik për të dhënë informacion dhe ndihmë aktive, sipas këtij neni, konsiston në dhënien e informacionit të përgjithshëm, por nuk përfshinë ndihmën juridike për rastet individuale.

Pretendimet e tjera të paditësit të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore, nga neni 160 paragraf 4 dhe 5, neni 182 paragraf 2, pika (n) dhe 183 të LPK-së, dhe nenit 22 paragraf 2 të LKA-së, kolegji i kësaj gjykate i vlerëson se nuk janë të bazuara në fakte të qëndrueshme dhe relevante në baza ligjore, ngase gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të plotë dhe të drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe aplikuar dispozitat nga e drejta materiale.

Pretendimet lidhur me nenin 22 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Protokollin nr.12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo gjykatë i shqyrtoj me kujdes dhe vëmendje të veçantë por të njëjtat i vlerësoj si të pabazuara ngase dispozitat lidhur me afatet dhe procedurat e përcaktuara ligjore si në rastin konkret janë të natyrës imperative, dhe mosrespektimi i tyre nga palët, nuk konsiston në shkeljen e të drejtave të garantuara me kushtetutë apo me akte-instrumente ndërkombëtare të ratifikuara dhe të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për vendosjen ndryshe në këtë çështje, nga ajo e vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *"Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes".*

Mbi këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se pretendimet e paditësit janë të pabazuara dhe të pa ndikim për një gjendje ndryshe faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Vendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Përveç kësaj, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

2023:251326

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.209/2023, më datë 18 Janar 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani